



Demo Klinike

John Sample

Mosha: 25

Gjinia: Male

Norma e standardizuar Prysma

Hyrje

Ky raport ndihmon në kuptimin e disa aspekteve të rëndësishme për funksionimin klinik të personit të vlerësuar. Përshkrimi bazohet në shkallë psikometrike të standardizuara, të cilat mund të vlerësojnë simptoma, vështirësi emocionale, të sjelljes ose njohëse, nivele rreziku ose fusha të tjera me relevancë klinike.

Raporti është krijuar për t'u përdorur në veprimtarinë e psikologëve, klinikistëve, këshilluesve ose profesionistëve të tjerë të specializuar. Megjithëse është formuluar në një gjuhë të kuptueshme, rezultatet duhet të interpretohen nga një specialist, në varësi të kontekstit të vlerësimit.

Rezultatet nuk përbëjnë, në vetvete, një diagnozë. Ato duhet të merren në konsideratë së bashku me të dhënat e marra nëpërmjet intervistës klinike, vëzhgimit, anamnezës, dokumenteve relevante ose instrumenteve të tjera psikometrike.

Në rastin e shkallëve klinike, një rezultat i lartë mund të tregojë një nivel më të theksuar të treguesit të vlerësuar, por nuk konfirmon automatikisht praninë e një çrregullimi. Interpretimi duhet të kryhet duke i ndërthurur të gjitha informacionet e disponueshme.

Profili i përgjithshëm

Faqja që vijon përmban profilin e përgjithshëm të personit të vlerësuar, në formën e një grafiku të rezultateve të marra në shkallët klinike të administruara. Profili mund të përfshijë një numër të ndryshueshëm shkallësh, në varësi të konfigurimit të administrimit.

Secila shkallë paraqitet në një rresht, ndërsa vlerat shfaqen numerikisht dhe grafikisht. Për secilën shkallë mund të tregohen rezultati bruto, percentili dhe rezultati i standardizuar T. Paraqitja grafike ilustron percentilet në një bosht nga 0 deri në 100.

Rezultatet e standardizuara lejojnë krahasimin me kampionin normativ të përdorur gjatë skorimit. Në rastin e shkallëve klinike, kuptimi i rezultateve varet nga treguesi i vlerësuar. Rezultatet e theksuara sinjalizojnë fusha që mund të kërkojnë analizë të mëtejshme.

Profili i përgjithshëm

B = Rezultati bruto

C = Percentili

T = Rezultati T

Shkallët klinike të personalitetit



B = Rezultati bruto

C = Percentili

T = Rezultati T

Perfeksionizmi rigid

16

21

42

Besime dhe përvoja të pazakonta

11

46

49

Ekscentriciteti

19

93

65

Çrregullime kognitive dhe perceptuale

18

93

65

Shkallët klinike të simptomave tërthore

Depresioni

14

42

48

Zemërimi

15

50

50

Mania

22

86

61

Ankthi

20

76

57

Simptomat somatike

22

96

68

Ideacioni suicidal

14

79

58

Psikoza

18

99

72

Çrregullime të gjumit

22

90

63

Çrregullime të kujtesës

18

84

60

Mendime dhe sjellje të përsëritura

20

90

63

Disociimi

20

98

70

Funksionimi i personalitetit

17

90

63

Abuzimi me substanca

13

73

56

Çrregullimi i stresit post-traumatik

17

73

56

Varësia dixhitale

24

88

62

Vetëzbulimi

21

86

61

Theksimi i problemeve

24

99

75

Rezultatet e detajuara

Raporti i detajuar ofron një përshkrim verbal të rezultateve të marra në shkallët klinike të administruara dhe të paraqitura në profilin e përgjithshëm. Komentet bazohen në normën e përdorur gjatë skorumit të testit dhe kanë për qëllim të mbështesin interpretimin klinik.


Për secilën shkallë paraqitet një grafik që tregon pozicionin e rezultatit mbi bazën e percentilit, në një bosht nga 0 deri në 100. Shfaqen vlerat numerike që korrespondojnë me rezultatin bruto, rezultatin T dhe percentilin, kur këto janë të disponueshme.

Nën secilin grafik përfshihet një përkufizim i shkallës. Për shkallët klinike, përshkrimet e lidhura me rezultatet e ulëta dhe të larta duhet të lexohen si nivele të treguesit të vlerësuar, jo si etiketa diagnostike. Rezultatet e theksuara duhet të interpretohen së bashku me informacionet klinike të marra nga burime të tjera.

Si lexohen rezultatet

- B** rezultati bruto: numri i pikëve të grumbulluara në pyetjet e shkallës, para krahasimit me kampionin normativ.
- C** percentili: përqindja e personave nga kampioni normativ që marrin një rezultat të barabartë ose më të ulët.
- T** rezultati i standardizuar, me mesatare 50 dhe devijim standard 10.

Shpërndarja normale e rezultateve në popullatën e referencës




Rezultatet e larta ose të ulëta nuk janë rezultate të mira ose të dobëta. Ato tregojnë pozicionin e personit të vlerësuar në raport me kampionin normativ dhe interpretohen së bashku me të dhënat e tjera të vlerësimit.

CP1

Labiliteti emocional

B: 15 | T: 53 | C: 62%



Përkufizim: Kjo shkallë kap paqëndrueshmërinë e gjendjeve shpirtërore dhe të përjetimeve emocionale; shkalla pasqyron mbireagimin ndaj ngjarjeve a situatave, si dhe një nivel të lartë aktivizimi të emocioneve intensive.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë perceptohen si të qëndrueshëm emocionalisht, me reagime të parashikueshme dhe, në përgjithësi, të përshtatshme me situatat e kontekstet nëpër të cilat kalojnë. Këta persona nuk i shprehin me intensitet emocionet negative dhe zakonisht nuk kalojnë tepër lehtë nga një gjendje emocionale në tjetrën.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kalojnë shumë shpejt nga një gjendje emocionale në tjetrën. Këta persona mund ta ndryshojnë befasisht gjendjen emocionale dhe mund të kenë reagime emocionale joproporcionale me situatën a kontekstin specifik në të cilin ndodhen. Gjithashtu, personat me rezultate të larta mund të ndiejnë zemërim ose afekte të tjera negative me intensitet shumë të lartë.

CP2

Shqetësimi

B: 17 | T: 54 | C: 66%



Përkufizim: Shkalla e Shqetësimit identifikon ndjenja frike, brengje dhe ruminimi të lidhura me ngjarje të shkuara a të ardhshme, si dhe pritshmëri negative lidhur me përvoja ose ngjarje.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin konsum të tepruar emocional lidhur me situata a vendime relativisht të zakonshme. Ata nuk ndiejnë frikëra a shqetësime jospesifike në një masë më të madhe se shumica e popullsisë.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë janë të prirur të ndiejnë shpesh frikëra dhe shqetësime. Ata shqetësohen para ngjarjeve a situatave të rëndësishme dhe kanë një konsum të lartë emocional lidhur me gjëra a vendime relativisht të zakonshme.

CP3

Ankthi i ndarjes

B: 25 | T: 67 | C: 96%



Përkufizim: Shkalla identifikon frikën nga vetmia, nga braktisja a refuzimi prej personave të rëndësishëm, duke kapur njëkohësisht edhe perceptimin e paaftësisë për të menaxhuar jetën e vet, si në rrafshin konkret, ashtu edhe në atë emocional.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë shfaqin një pavarësi relative ndaj personave të rëndësishëm, duke mos qenë të prirur të ndiejnë afekte negative kur nuk janë në kontakt me ta. Zakonisht, këta persona mund t'i menaxhojnë problemet e përditshme pa ndier nevojën për mbështetje emocionale nga personat e rëndësishëm.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë ndihen të cenueshëm kur nuk janë pranë personave të rëndësishëm. Ata e menaxhojnë me vështirësi vetminë, edhe kur ajo është vetëm e përkohshme. Kur kalojnë çaste të vështira, personat me rezultate të larta shqetësohen nga mendimi se mund të braktisen.

CP4

Nënshtgueshmëria

B: 17 | T: 54 | C: 66%



Përkufizim: Shkalla mat prirjen e theksuar për ta ndryshuar e përshtatur sjelljen e vet me interesat dhe dëshirat e të tjerëve, edhe në dëm të interesave, dëshirave a nevojave të veta.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta nuk shfaqin vështirësi në ndjekjen e qëllimeve a vendimeve të veta kur ato ndryshojnë nga ato të shumicës. Këta persona nuk do të heqin dorë lehtë nga mendimet personale dhe nuk janë të prirur t'i braktisin ato thjesht për të arritur konsensus.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë priren të ndjekin vendimet ose preferencat e të tjerëve, duke hequr dorë nga mendimet a qëllimet e veta. Ata janë të kujdesshëm të mos i mërzitin ata përreth, duke u përpjekur t'u pëlqejnë. Këtyre personave u vjen e vështirë t'i refuzojnë të tjerët.

CP5

Armiqësia

B: 18 | T: 61 | C: 86%



Përkufizim: Kjo shkallë pasqyron përjetimin e shpeshtë të gjendjeve të zemërimit dhe të një gjendjeje të irrituar që çon në shfaqjen e reagimeve të ekzagjeruara ndaj ngjarjeve a gabimeve të vogla.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta nuk nervozohen lehtë dhe nuk kanë prirjen të jenë armiqësorë ose ta shfaqin zemërimin ndaj personave të tjerë. Gjendja emocionale e tyre në sfond nuk është e irrituar. Gjithashtu, personat me rezultate të ulëta do të kenë njëfarë përmbajtjeje në shprehjen e zemërimit a të afekteve negative.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë janë të prirur të nervozohen lehtë me të tjerët, duke pasur një gjendje të irrituar. Gjithashtu, këta persona priren ta shfaqin haptas armiqësinë, dhunën në gjuhë a në qëndrime. Rezultatet e larta shoqërohen me prirjen për t'i qortuar dhe për t'u vërsulur të tjerëve.

CP6

Perseverimi

B: 14 | T: 46 | C: 34%



Përkufizim: Shkalla kap qëndrueshmërinë në kryerjen e veprimtarive dhe sjelljeve shumë kohë pasi ato kanë humbur qëllimin a vlerën funksionale; vazhdimin e përsëritur të së njëjtës sjellje pavarësisht dështimeve sistematike ose efekteve negative.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin orientim drejt zhvillimit të ritualeve a rutinave keqpërshtatëse. Gjithashtu, personat me rezultate të ulëta kanë më pak gjasa të fiksohen pas veprimtarive të përsëritura, duke treguar fleksibilitet e rrjedhshmëri në zgjedhjen e veprimtarive.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë priren të ngulmojnë në veprimtari të përsëritura pa pasur një qëllim të përcaktuar mirë. Këta persona zhvillojnë rituale a rutina ndaj të cilave shfaqin një nivel të ulët fleksibiliteti dhe të cilat i ndjekin edhe kur ato nuk kanë rol përshtatës. Këtyre personave u vjen e vështirë të ndalen nga rutinat a ritualet e tyre.

CP7

Prirje depressive

B: 13 | T: 54 | C: 66%



Përkufizim: Shkalla mat ekzistencën e një gjendjeje depressive, ndjenjash pavlefshmërie, pashprese, pesimizmi dhe ndjenjash të vazhdueshme faji, turpi, përkatësisht ndjesisë së papërshtatshmërisë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirjen për të ndier një nivel të lartë trishtimi a pesimizmi. Zakonisht këta persona nuk kanë një imazh fort negativ për veten dhe nuk i nënvlerësojnë meritat e vlerën e tyre personale.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta ndiejnë më shpesh mungesën e kuptimit të jetës së vet, ndjenja trishtimi të shoqëruara me humbjen e interesit a të kënaqësisë për hobi. Zakonisht këta persona janë pesimistë dhe e vlerësojnë negativisht vetveten, duke shfaqur njëkohësisht një nivel të ulët vitaliteti e energjie.

CP8

Dyshimi

B: 13 | T: 48 | C: 42%



Përkufizim: Kjo shkallë identifikon vëmendjen e shtuar ndaj qëllimeve negative të të tjerëve, dyshimet lidhur me besnikërinë e tyre, si dhe ndjesinë e të qenit i shfrytëzuar dhe/ose i persekutuar.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personave me rezultate të ulëta u vjen më lehtë t'u besojnë të tjerëve, sepse nuk i dyshojnë për qëllime negative. Gjithashtu, këta persona nuk do të kenë prirjen të kërkojnë prova se të tjerët komplotojnë kundër tyre duke interpretuar sjellje e gjeje të vogla.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta janë të bindur se persona të tjerë kërkojnë të përfitojnë prej tyre dhe për këtë arsye priren të jenë shumë të kujdesshëm ndaj sjelljes e qëllimeve të të tjerëve. Këtyre personave u vjen e vështirë t'u besojnë qëllimeve të mira të të tjerëve. Shpesh, personat me rezultate të larta janë të bindur se të tjerët komplotojnë për t'i sabotuar.

CP9

Afektiviteti i kufizuar

B: 23 | T: 70 | C: 98%



Përkufizim: Shkalla kap një nivel jashtëzakonisht të ulët të reagueshmërisë emocionale, edhe ndaj situatave me ngarkesë të lartë emocionale; shpërndarja, distancimi dhe mungesa e shprehshmërisë emocionale janë gjithashtu elemente të kapura nga kjo shkallë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta shfaqin një gamë më të gjerë emocionale, duke e pasur relativisht të lehtë të empatizojnë me përjetimet emocionale të tjerëve. Këta persona prirën të kenë reagueshmëri emocionale ndaj situatave e konteksteve me ngarkesë emocionale. Gjithashtu, personat me rezultate të ulëta mund të perceptohen si persona të ngrohtë, me të cilët ndërvepron lehtë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta perceptohen si të distancuar dhe të pandjeshëm, me reagime emocionale të kufizuara edhe në situata a kontekste që zakonisht ngjallin përgjigje emocionale intensive. Këta persona prirën të mos empatizojnë me vuajtjen a vështirësitë emocionale të tjerëve, duke qenë njëkohësisht të rezervuar në shprehjen e gjendjeve të veta afektive.

CP10

Tërheqja

B: 18 | T: 59 | C: 82%



Përkufizim: Shkalla kap prirjen për t'u shmangur nga ndërveprimet sociale dhe mosinteresimin për ndërtimin a ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore. Elementet qendrore të shkallës përfshijnë si mospjesëmarrjen në veprimtari shoqërore, ashtu edhe një nivel të ulët të integritit shoqëror e të rrjetit të kontakteve sociale.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta përfshihen aktivisht në jetën shoqërore, marrin pjesë në ngjarje sociale dhe nisin kontakte, ndërveprime e biseda me të tjerët. Këta persona kujdesen për ruajtjen e kontakteve shoqërore dhe krijojnë miq të rinj me lehtësi.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta shmangin ndërveprimet sociale, veçanërisht nëse ato ndodhin në kontekste të organizuara ku marrin pjesë disa persona. Këtyre personave u vjen e vështirë të nisin e të mbajnë biseda, duke preferuar ta kalojnë kohën në veprimtari të vetmuara. Shpesh këta persona kanë një rrjet shoqëror të kufizuar.

CP11

Shmangia e intimitetit

B: 22 | T: 71 | C: 98%



Përkufizim: Shkalla kap mungesën e gatishmërisë për lidhje afektive me të tjerët. Një përbërës i rëndësishëm i kësaj shkalle është shmangia e afisë emocionale, qoftë në formën e marrëdhënieve në çift, qoftë të atyre të miqësisë a bashkëpunimit, përkatësisht shmangia e marrëdhënieve të lidhjes dhe e investimit emocional në marrëdhëniet me persona të tjerë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta kërkojnë afri dhe intimitet në marrëdhënie. Ata janë të orientuar drejt lidhjeve emocionale dhe marrëdhënieve të afisë me persona të cilët investojnë nga ana emocionale. Cilësia e marrëdhënieve me personat e afërt mund të jetë shumë e rëndësishme për personat me rezultate të ulëta.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë shmangin lidhjen me persona të tjerë ose marrëdhëniet e karakterizuara nga intimiteti emocional me ta. Gjithashtu, afria ndërpersonale a fizike u krijojnë një gjendje shqetësimi, ku këta persona preferojnë të ruajnë distancën në marrëdhëniet me të tjerët.

CP12

Anhedonia

B: 21 | T: 67 | C: 96%



Përkufizim: Shkalla kap prirjen drejt mungesës kronike të kënaqësisë që rrjedh nga veprimtaritë çlodhëse, nga arritja e qëllimeve ose nga lloje të tjera veprimtarish që zakonisht janë burim përmbushjeje. Kjo shkallë përfshin edhe mungesën e interesit a të vitalitetit specifik për përfshirjen në veprimtari të këndshme ose që sjellin përmbushje në rrafshin personal a profesional.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta shfaqin lehtësi në gëzimin e veprimtarive a ngjarjeve të përditshme. Ata paraqesin një nivel të lartë vitaliteti e energjie, duke e pasur relativisht të lehtë të interesohen për veprimtari e projekte të ndryshme.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta shfaqin një mungesë kronike të kënaqësisë që rrjedh nga veprimtaritë ose nga marrëdhëniet ndërpersonale. Këta persona priren të mos përfshihen në veprimtari çlodhëse dhe paraqesin, në përgjithësi, një nivel të ulët vitaliteti e entuziazmi.

CP13

Prirje manipuluese

B: 19 | T: 55 | C: 69%



Përkufizim: Shkalla kap prirjen për të përdorur sharmin personal, lajkat ose mjete të tjera për arritjen e qëllimeve personale përmes manipulimit dhe ndikimit të tjerët.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin interes për të ndikuar te të tjerët me qëllim arritjen e qëllimeve të veta. Këta persona prirjen të jenë transparentë në komunikimin e objektivave e synimeve që ndjekin dhe, në përgjithësi, nuk u pëlqen t'i shtyjnë të tjerët të bëjnë gjëra në dobi të tyre.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë prirjen të përdorin çdo mjet për të ndikuar te sjellja e të tjerëve në drejtim të arritjes së qëllimeve personale. Këta persona prirjen t'i shohin të tjerët si mjete për realizimin e synimeve personale. Gjithashtu, personat me rezultate të larta mund të shfaqin një nivel të lartë karizme e sharmi personal.

CP14

Mashtrimi

B: 13 | T: 48 | C: 42%



Përkufizim: Shkalla identifikon prirjen për të shpikur ngjarje ose attribute personale, mungesën e sinqeritetit apo edhe prirjen për t'u përfshirë në sjellje tipike të dinakërisë ose të mashtimit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin orientim drejt mashtimit të të tjerëve, duke u perceptuar shpesh si të ndershëm. Këta persona nuk e teprojnë rëndësinë e vetes apo të arritjeve të veta dhe i paraqesin me sinqeritet si cilësitë, ashtu edhe të metat.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë prirjen të shpikën ngjarje ose kontekste, duke përdorur shpesh gënjeshtërën ose teprimet për të arritur objektivat e tyre. Këta persona e paraqesin shpesh në mënyrë të shtrembëruar kontributin e vet, duke e tepruar rëndësinë dhe rolin e tyre në ngjarje të ndryshme. Ndonjëherë, këta persona përbëjnë rrezik për përfshirje në sjellje mashtrimi ose fraude.

CP15

Grandioziteti

B: 17 | T: 55 | C: 69%



Përkufizim: Ky dimension pasqyron bindjen se vetja është superiore, se ka attribute dhe karakteristika të veçanta që kërkojnë vlerësim dhe njohje; shkalla kap edhe ndjenjën e epërsisë dhe qëndrimin se personit i takon vëmendje e posaçme.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk e konsiderojnë veten të veçantë apo të jashtëzakonshëm. Ata kanë një imazh për veten të lidhur me realitetin dhe nuk presin të marrin trajtim të posaçëm nga të tjerët.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë një ndjenjë të fortë epërsie, duke menduar se meritojnë trajtim të posaçëm nga të tjerët dhe se kanë arritje të jashtëzakonshme. Këta persona kanë një vetëvlerësim të tepruar, duke menduar se janë më kompetentë dhe më të aftë se shumica e personave rreth tyre.

CP16

Kërkimi i vëmendjes

B: 17 | T: 55 | C: 69%



Përkufizim: Shkalla identifikon prirjen për të tërhequr vëmendjen sociale me çdo kusht, për t'u bërë i dukshëm dhe për të marrë vlerësimin e admirimin e të tjerëve.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta nuk shfaqin prirjen për të qenë në qendër të vëmendjes. Ata karakterizohen shpesh nga diskrecioni dhe mund të ndihen keq kur vëmendja e të tjerëve drejtohet nga ata.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kërkojnë sistematikisht të tërheqin vëmendjen e të tjerëve, duke shfaqur sjellje ose qëndrime të ndryshme vetëm me qëllim që të jenë në qendër të vëmendjes. Këtyre personave u pëlqen të bien në sy, të vihen re dhe të vlerësohen nga të tjerët, duke u ndier keq kur persona të tjerë marrin vëmendje në kontekste sociale.

CP17

Mizoria

B: 19 | T: 66 | C: 95%



Përkufizim: Ky dimension identifikon mungesën e empatisë ndaj vuajtjes së të tjerëve, indiferencën ndaj problemeve të tyre, si dhe mungesën e shqetësimit për efektin e veprimeve të veta mbi të tjerët.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë kanë një qëndrim të ngrohtë ndaj të tjerëve dhe empatizojnë me vuajtjen ose vështirësitë e tyre. Për këta persona është më e rëndësishme të mos u shkaktojnë vuajtje e probleme të tjerëve sesa të arrijnë objektivat e veta. Këta persona mund të shfaqin ruminime dhe faj lidhur me mundësinë që t'u kenë shkaktuar probleme ose vuajtje të tjerëve.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta shfaqin një indiferencë relative ndaj vuajtjes ose problemeve nëpër të cilat kalojnë persona të tjerë. Ata nuk reagojnë lehtë ndaj vuajtjes së të tjerëve dhe, në përgjithësi, u mungojnë pendesat ose faji në raport me personat e tjerë. Për këta persona arritja e objektivave është më e rëndësishme se vuajtjet e mundshme që mund t'u shkaktojnë të tjerëve.

CP18

Papërgjegjshmëria

B: 19 | T: 63 | C: 90%



Përkufizim: Shkalla mat mungesën e shqetësimit dhe indiferencën ndaj përmbushjes së detyrimeve dhe premtimeve të marra përsipër, pavarësisht nga rëndësia e pasojave, si dhe prirjen për të vendosur e për të vepruar sipas qejfit, dhe jo sipas synimeve, objektivave apo dobisë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Për personat me rezultate të ulëta fjala e dhënë është jashtëzakonisht e rëndësishme, duke bërë çdo përpjekje për të respektuar premtimet dhe për të mbajtur angazhimet e marra përsipër. Për këtë arsye të tjerët i perceptojnë si persona të besueshëm, te të cilët mund të mbështeten.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta priren t'i shkelin premtimet e veta dhe të mos e mbajnë fjalën, duke u perceptuar kështu si të papërgjegjshëm, ndërsa të tjerëve u është e vështirë të kenë besim tek ata. Për më tepër, këta persona veprojnë më shumë sipas asaj që u pëlqen, dhe jo sipas angazhimeve të marra përsipër, duke u gjendur më shpesh në situatën për të mos i nderuar premtimet e veta.

CP19

Impulsiviteti

B: 18 | T: 56 | C: 73%



Përkufizim: Dimensioni i impulsivitetit kap reagime të shpejta ndaj stimujve të menjëhershëm, pa marrë parasysh planin dhe objektivat afatgjata; vështirësinë për të ruajtur një plan, përkatësisht vështirësinë për të menaxhuar emocionet e veta dhe për t'u rezistuar tundimeve.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta kanë një prirje drejt analizës dhe kujdesit, duke preferuar të peshojnë pasojat e veprimeve të veta. Këta persona mund të kenë nevojë për më shumë kohë për të marrë vendime, duke analizuar me kujdes implikimet e tyre. Gjithashtu, personat që marrin rezultate të ulëta prirën t'u rezistojnë tundimeve dhe të mos marrin vendime të nxituara, nën impulsin e çastit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë prirën të veprojnë para se të mendojnë ose të analizojnë pasojat e veprimeve të veta. Ata preferojnë të marrin vendime nën impulsin e çastit dhe mund të kenë vështirësi t'u rezistojnë tundimeve ose impulseve të veta të çastit. Për këto arsye personat me rezultate të larta prirën të perceptohen si të nxituar dhe impulsivë.

CP20

Shpërqendrimi

B: 11 | T: 43 | C: 24%



Përkufizim: Shkalla identifikon vështirësinë për të përqendruar vëmendjen dhe për ta ruajtur atë për periudha më të gjata kohe; vështirësi për të mbajtur sjellje të orientuara drejt qëllimit, veçanërisht kur shfaqen shpërqendruar.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë e ruajnë përqendrimin te detyrat ose bisedat dhe prirën të mos kenë vështirësi ta fokusojnë vëmendjen te detyrat rutinore. Gjithashtu, këtyre personave nuk u shkaktojnë probleme faktorët shqetësues, ndërsa shpërqendrimi është shumë rrallë problem për ta.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë, në përgjithësi, vështirësi për ta mbajtur vëmendjen të përqendruar në detyra ose edhe në ndërveprimet me persona të tjerë. Vëmendja e tyre mund të shpërqendrohet lehtë nga stimuj të tjerë, edhe kur janë të përqendruar në një detyrë të rëndësishme. Këtyre personave mund t'u jetë e vështirë ta ruajnë vëmendjen te detyrat rutinore ose për periudha të gjata kohe.

CP21

Kërkimi i rrezikut

B: 13 | T: 42 | C: 21%



Përkufizim: Shkalla kap prirjen për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme, prirjen për të nënvlerësuar rreziqet objektive dhe mungesën e shqetësimit për pasojat e veprimeve të veta.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta kanë një tolerancë relativisht të ulët ndaj rrezikut dhe shmangin situatat ose veprimtaritë që paraqesin rreziqe për veten ose për të dashurit e tyre. Këtyre personave mund t'u jetë e vështirë të marrin përsipër rreziqe dhe mund të kenë prirjen të teprojnë pasojat e mundshme të veprimtarive ose të hobive që praktikojnë.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë shfaqin një predispozitë për t'u përfshirë në veprimtari rrezikuese, të rrezikshme. Ata kanë një oreks të lartë për veprimtari si sportet ekstreme ose hobi që përfshijnë një shkallë të lartë rreziku. Këta persona priren t'i shpërfillin pasojat që kanë implikime serioze për sigurinë e vetes.

CP22

Perfeksionizmi rigid

B: 16 | T: 42 | C: 21%



Përkufizim: Kjo shkallë mat këmbënguljen për përfundimin e përsosur të veprimtarive; tolerancën e ulët ndaj gabimeve, qofshin edhe të vogla; vlerësimin rigid dhe të bazuar në standarde joreale të performancës së vet, si dhe të të tjerëve; përqendrimin e tepruar te procedurat dhe detajet.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta nuk shqetësohen për detajet dhe as për kontrollin e punës së vet; i konsiderojnë elementet formale dhe detajet si më pak të rëndësishme se ato thelbësore. Këta persona perceptohen si ndonjëherë tepër fleksibël dhe mund të kenë vështirësi ta ndjekin me përpikëri një procedurë ose një plan.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë priren të analizojnë në thellësi edhe detajet më të vogla. Këta persona e kontrollojnë shpesh punën e tyre më shumë herë sesa do të ishte e nevojshme, nga frika se mos bëjnë gabime. Gjithashtu, këta persona perceptohen si perfeksionistë dhe pa fleksibilitet kur shfaqen situata të paplanifikuara.

CP23

Besime dhe përvoja të pazakonta

B: 11 | T: 49 | C: 46%



Përkufizim: Shkalla mat bindjen për ekzistencën e aftësive dhe fuqive të mbinatyrshme, si aftësia për të lexuar mendjen e të tjerëve ose telekineza, si dhe për ekzistencën e përvojave të mbinatyrshme.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin besime ose bindje irracionale lidhur me përvojat e veta apo me aftësitë e veta.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë perceptohen si bizarrrë dhe priren të kenë interesa të pazakonta për ezoterizmin ose të mbinatyrshmen. Këta persona janë të bindur se kanë pasur përvoja të mbinatyrshme ose se kanë disa aftësi të veçanta apo të jashtëzakonshme (si, për shembull, telekinezën ose aftësinë për të parashikuar të ardhmen).

CP24

Ekscentriciteti

B: 19 | T: 65 | C: 93%



Përkufizim: Shkalla pasqyron bizarrinë në nivel sjelljeje, në shprehjen verbale ose në nivel të pamjes së jashtme, si dhe bindje e qëndrime që ndryshojnë nga ato të shumicës së popullsisë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin bizarrri në nivel sjelljeje apo prirje drejt ekscentricitetit në regjistrin e bindjeve ose të veprimeve.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta perceptohen si të çuditshëm, atipikë ose ekscentrikë. Ata mund të kenë opinione shumë të ndryshme nga ato të shumicës, ndërsa mënyra e tyre e sjelljes ose e veshjes mund të perceptohet si bizarre.

CP25

Çrregullime kognitive dhe perceptuale

B: 18 | T: 65 | C: 93%



Përkufizim: Kjo shkallë mat ekzistencën e proceseve dhe përvojave të pazakonta, si depersonalizimi, mungesa e kontaktit me realitetin ose ngatërrimi i gjendjeve të ëndrrës me realitetin.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë kanë një ndjenjë koherente të hapësirës dhe të kohës, me një predispozitë të ulët për t'u ndier jashtë hapësirës ose kohës. Këta persona janë të lidhur me realitetin dhe me aspektet konkrete të tij.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë janë të prirur të ndihen në një hapësirë ose kohë tjetër nga ajo e tashmja. Ata mund të shfaqin konfuzion, duke pasur shpesh ndjenjën e joreales ose ndjenjën se ngjarjet reale ndodhin si në ëndërr. Ndonjëherë këto prirje mund të shoqërohen edhe me përvoja të mbinatyrshme.

CT1

Depresioni

B: 14 | T: 48 | C: 42%



Përkufizim: Shkalla e Depresionit tregon praninë relativisht të qëndrueshme dhe përshkuese të ndjenjave të pesimizmit, trishtimit, palumturisë dhe mungesës së kuptimit. Kjo shkallë tregon zakonisht një prirje për të zhvlerësuar vetveten dhe arritjet e veta, si dhe mungesën e shpresës për një të ardhme më të mirë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë tregojnë mungesë të trishtimit, të mungesës së energjisë a entuziazmit ose të elementeve të tjera karakteristike të Depresionit.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë ndihen të trishtuar dhe të dëshpëruar, duke humbur interesin për hobi dhe veprimtari çlodhëse. Ata ndihen të përkulur, me moral të ulët dhe pa energji, vitalitet a optimizëm.

CT2

Zemërimi

B: 15 | T: 50 | C: 50%



Përkufizim: Kjo shkallë identifikon ekzistencën e një gjendjeje të irrituar, që parapërgatit shfaqjen e reagimeve të nervozizmit ose zemërimit për arsye banale. Shkalla kap edhe prirjen për ta shfaqur nga jashtë irritimin ose zemërimin.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin një gjendje të irrituar dhe as prirjen për t'u nervozuar lehtë ose për ta shfaqur nga jashtë irritimin a zemërimin.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë shfaqin një prirje për t'u zemëruar. Ata perceptohen si „gjaknxehtë“. Meqë kanë një gjendje të irrituar, këta persona mund të zemërohen për asgjë dhe shpesh do të jenë të prirur ta shfaqin zemërimin nga jashtë përmes sjelljesh agresive ose edhe të dhunshme.

CT3

Mania

B: 22 | T: 61 | C: 86%



Përkufizim: Kjo shkallë karakterizohet nga qëndrueshmëria e një gjendjeje ekspansive, që tregon praninë e një niveli shumë të lartë aktivizimi e energjie, të kombinuar me kalimin shumë të shpejtë nga një veprimtari në tjetrën ose me ndryshimin e shpeshtë të interesave për veprimtari a veprime.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin nivelin e intensitetit dhe të energjisë specifik për këtë shkallë. Përfshirja e tyre në projekte e veprimtari nuk ushqehet nga gjendja ekspansive tipike e shkallës së Manisë.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat që shfaqin rezultate të larta në shkallën e Manisë priren të shfaqin një nivel jashtëzakonisht të lartë energjie e vitaliteti. Kjo gjendje ekspansive i parapërgatit të përfshihen në një numër tepër të madh veprimtarish a projektesh dhe të entuziazmohen ose të marrin përsipër angazhime të reja shumë lehtë. Niveli i tyre i energjisë priret të mbetet i lartë, edhe nëse nuk rimëkëmben ose nuk pushojnë.

CT4

Ankthi

B: 20 | T: 57 | C: 76%



Përkufizim: Kjo shkallë kap ndjenja ankthi, tensioni dhe frike, të pranishme edhe në situata relativisht pa rreziqe objektive. Gjendjet e shqetësimit specifike për këtë shkallë shoqërohen zakonisht me pranimë e mendimeve se diçka e keqe do t'i ndodhë vetes ose personave të afërt.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirje për t'u shqetësuar dhe as tendencën për të përfytyruar skenarët më negativë a më të rrezikshëm. Ata mund të perceptohen si të qetë dhe të relaksuar.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Kjo shkallë tregon pranimë e një gjendjeje frike e shqetësimi që nuk shpjegohet me pranimë e konteksteve të rrezikshme. Personat me rezultate të larta shfaqin prirjen për t'u shqetësuar dhe për të pasur pritshmëri negative lidhur me situata relativisht të zakonshme, duke u sulmuar shpesh nga mendime ose imazhe në të cilat ndodh diçka e keqe a negative.

CT5

Simptomat somatike

B: 22 | T: 68 | C: 96%



Përkufizim: Kjo shkallë identifikon prirjen për të ndier simptoma fizike, si dhimbje koke, barku ose nyjesh, pa një shkak të caktuar apo arsye mjekësore të përcaktuar mirë. Prania e këtyre simptomave nuk shpjegohet nga asnjë gjendje mjekësore ekzistuese.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirjen për të raportuar simptoma somatike që nuk shpjegohen nga gjendje mjekësore objektive. Ata nuk shfaqin shqetësime të tepruara lidhur me gjendjen shëndetësore ose me sëmundjet e mundshme që mund të kenë.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë raportojnë pranimë e simptomave somatike, si dhimbje koke, barku ose një gjendje të përgjithshme shëndetësore të dobët – simptoma që nuk shpjegohen nga një shkak mjekësor objektiv. Shpesh këta persona ndiejnë se problemet e tyre shëndetësore nuk merren seriozisht nga të tjerët dhe se nuk marrin mjaftueshëm kujdes prej tyre.

CT6

Ideacioni suicidal

B: 14 | T: 58 | C: 79%



Përkufizim: Kjo dimension kap pranimë e ideacionit suicidal, të shoqëruar zakonisht nga një ndjenjë e mprehtë pashprese. Krahas humbjes së shpresës, shkalla përfshin edhe ekzistencën e një gjendjeje depressive në sfond. Shkalla identifikon gjithashtu prirjen drejt vetëdëmtimit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin ideacion suicidal ose prirje drejt vetëdëmtimit.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë mendime ose imazhe për vetëdëmtim a vetëvrasje. Këto mendime janë shpesh të pakontrollueshme dhe mund të çojnë në sjellje vetëdëmtuese të shkallëve të ndryshme.

CT7

Psikoza

B: 18 | T: 72 | C: 99%



Përkufizim: Shkalla e Psikozës tregon pranimë e halucinacioneve që mund të kenë ose jo elemente bizare. Ndër to përfshihen ndjesia se të tjerët mund t'i dëgjojnë mendimet e personit, bindja se po ndiqet, si dhe bindje lidhur me aftësi të veçanta, si aftësia për të dëgjuar, parë ose komunikuar me entitete mbinatyrore.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirjen për të menduar se kanë aftësi të veçanta për të perceptuar gjëra a aspekte të realitetit që të tjerët nuk i vërejnë. Ata janë relativisht të lirë nga prirje psikotike.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë dëgjojnë ose shohin gjëra që nuk ekzistojnë në realitet, me përshtypjen se janë të vetmit që mund t'i shohin ato aspekte të realitetit. Një element i shpeshtë i lidhur me rezultatet e larta është bindja se mund të komunikojnë me entitete mbinatyrore ose se mendimet e tyre po dëgjohen e ndiqen.

CT8

Çrregullime të gjumit

B: 22 | T: 63 | C: 90%



Përkufizim: Kjo shkallë kap ekzistencën e çrregullimeve të ciklit gjumë-zgjim, çrregullime që rezultojnë në pagjumësi, cenim të cilësisë së gjumit, vështirësi për të fjetur a për t'u zgjuar, ose në ndjesinë e mungesës së energjisë a çlodhjes pavarësisht numrit të orëve të gjumit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin çrregullime të ciklit gjumë-zgjim dhe, pavarësisht numrit objektiv të orëve të gjumit, ndihen të çlodhur e me një nivel normal energjie.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë vështirësi për të fjetur ose për të pasur një gjumë të pandërprerë. Gjumi i tyre nuk perceptohet si çlodhës dhe, për pasojë, këta persona ndihen të privuar nga gjumi e çlodhja, me një gjendje lodhjeje kronike.

CT9

Çrregullime të kujtesës

B: 18 | T: 60 | C: 84%



Përkufizim: Kjo shkallë i referohet vështirësisë për të rikujtuar informacione të zakonshme, si adresa e vet, emrat e personave a vendeve të njohura. Këto vështirësi mund të hasen edhe në lidhje me ngjarje, si vështirësia për të kujtuar filma a takime, përkatësisht biseda të fundit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk kanë vështirësi për të kujtuar gjëra a ngjarje nga e kaluara e afërt ose e largët, as për të mësuar informacione të reja.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë vështirësi në rikujtimin e informacioneve a detajeve për ngjarje ose situata të fundit apo të ndodhura shumë kohë më parë. Ata harrojnë shpesh informacione relativisht të zakonshme, si adresën e vet, emrat e të njohurve ose vendet ku kanë qenë së fundmi. Gjithashtu, personat me rezultate të larta mund të kenë vështirësi për të mësuar a mbajtur mend informacione të reja, vështirësi që nuk shpjegohen nga aftësi njohëse të ulëta.

CT10

Mendime dhe sjellje të përsëritura

B: 20 | T: 63 | C: 90%



Përkufizim: Shkalla kap ekzistencën e përsëritur e ndërhyrëse të mendimeve a ndjesive të padëshiruara (obsesione), përkatësisht prirjen për të shfaqur sjellje të caktuara të përsëritura me qëllim heqjen e tyre.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk kanë prirjen ta qetësojnë ankthin e krijuar nga imazhe të pakëndshme a të padëshiruara përmes kryerjes kompulsive të ritualeve ose veprimtarive të përsëritura.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta shfaqin prirjen për të kryer rituale a veprimtari të përsëritura nga të cilat e kanë të vështirë të ndalen. Këto rituale ose veprimtari të përsëritura mund të shprehen nga jashtë ose mund të zhvillohen vetëm në mendjen e personit. Gjithashtu, rezultatet e larta shoqërohen me praninë e mendimeve a imazheve ndërhyrëse dhe të pakontrollueshme për aspekte të pakëndshme ose të rrezikshme.

CT11

Disociimi

B: 20 | T: 70 | C: 98%



Përkufizim: Kjo shkallë mat ekzistencën e sjelljeve të depersonalizimit, distancimit dhe shkëputjes nga vetvetja. Gjendja e shkëputjes mund të shfaqet në raport me vetveten, si dhe në raport me përjetime a ngjarje të mëparshme në të cilat personi ka qenë i përfshirë.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk kanë ndjesi tjetërsimi ndaj vetvetes ose ndaj ngjarjeve të jetës. Ata janë të lidhur si me trupin e tyre, ashtu edhe me identitetin e tyre psikologjik.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë ndihen të shkëputur nga trupi i tyre ose nga identiteti i tyre psikologjik, duke i perceptuar ngjarjet e jetës së vet sikur po i ndodhin një personi tjetër. Këta persona kanë shpesh ndjesinë se po luajnë një rol në jetën e tyre reale, ku kjo gjendje shkëputjeje shkon deri në nivel shqisor, duke u shfaqur me distancim edhe nga ndjesitë trupore a dhimbja fizike.

CT12

Funksionimi i personalitetit

B: 17 | T: 63 | C: 90%



Përkufizim: Shkalla mat prirjen për të pasur ndjesinë e mungesës së drejtimit në jetë e të mungesës së qëllimit, të shoqëruar me perceptimin e një identiteti personal të papërcaktuar mirë, si dhe vështirësi në krijimin e mbajtjen e marrëdhënieve të afërta me të tjerët.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë kanë një pamje relativisht të qartë për qëllimet e tyre në jetë, me një ndjesi koherente të drejtimit që ndjek jeta e tyre. Ata nuk shfaqin vështirësi në krijimin e marrëdhënieve të karakterizuara nga afria dhe intimiteti psikologjik.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë ndjesinë se nuk e njohin vërtet veten, se nuk e dinë cilat janë qëllimet e tyre dhe se nuk kanë zbuluar çfarë duan të arrijnë në jetë. Përveç kësaj ndjesie mospërputhjeje me vetveten, rezultatet e larta në këtë shkallë shoqërohen me mungesën e dëshirës për, ose me vështirësi në marrëdhënie të afërta me të tjerët, ku këta persona ndiejnë se marrëdhëniet e afërta nuk përbëjnë një element të rëndësishëm në jetën e tyre.

CT13

Abuzimi me substanca

B: 13 | T: 56 | C: 73%



Përkufizim: Shkalla mat prirjen për të konsumuar alkool, duhan ose substanca të tjera me frekuencë të lartë, me qëllim ndryshimin e gjendjes emocionale. Gjithashtu, shkalla identifikon ndjesinë se personi nuk mund të funksionojë normalisht nga ana psikologjike a emocionale në mungesë të atyre substancave.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirjen për të konsumuar alkool a substanca të tjera për të ndryshuar gjendjen shpirtërore ose për të përballuar aspekte të jetës së përditshme.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në shkallën e Abuzimit me Substanca shfaqin prirjen për të konsumuar një sasi më të madhe alkooli sesa ajo që konsiderohet konsum normal a i rekomanduar. Kjo prirje mund të shfaqet edhe me konsumin e vazhdueshëm të substancave të tjera, jo vetëm të alkoolit, zakonisht me qëllim ndryshimin e gjendjes emocionale ose shmangien e përditshmit të gjendjeve negative a të pakëndshme.

CT14

Çrregullimi i stresit post-traumatik

B: 17 | T: 56 | C: 73%



Përkufizim: Shkalla kap ekzistencën e mendimeve a kujtimeve ndërhyrëse të lidhura me një ngjarje traumatike. Këto mund të shfaqen si ripërjetim i ndjesive specifike të ngjarjes traumatike, përmes kujtimit të gjallë të atyre përvojave ose përmes ëndrrave të lidhura me atë ngjarje.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk mundohen nga kujtime a përjetime të pakëndshme ose ndërhyrëse të lidhura me ngjarje traumatike. Rezultatet e ulëta nuk japin informacion për mosekzistencën e ngjarjeve traumatike në historikun personal.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta përjetojnë relativisht shpesh gjendje a kujtime intensive të lidhura me një ngjarje të pakëndshme ose traumatike nëpër të cilën kanë kaluar. Ata mund të ndiejnë në të tashmen ndjesi me intensitetin e atyre që ishin specifike për ngjarjen traumatike. Zakonisht, mendimet ose imazhet për atë ngjarje kanë karakter ndërhyrës, të përsëritur dhe perceptohen si destabilizuese.

CT15

Varësia dixhitale

B: 24 | T: 62 | C: 88%



Përkufizim: Shkalla identifikon praninë e sjelljeve problematike dhe kompulsive në përdorimin e internetit (rrjete sociale, lojëra etj.) ose të teknologjive dixhitale, të cilat shfaqen për periudha të zgjatura kohe dhe cenojnë funksionimin e personit.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk i përdorin teknologjitë ose mediat sociale më shpesh se shumica e popullsisë, dhe gjendja a mirëqenia e tyre nuk përcaktohet nga qasja te teknologjitë apo përdorimi i tyre.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë perceptojnë se përdorimi i teknologjive ose qasja në rrjetet sociale luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e tyre psikologjik. Interesi i theksuar për këtë lloj veprimtarie sjell zakonisht humbjen e interesit për veprimtari të tjera të këndshme ose për ndërveprime shoqërore.

CT16

Vetëzbulimi

B: 21 | T: 61 | C: 86%



Përkufizim: Shkalla kap gatishmërinë e personave për të ndarë me të tjerët detaje për jetën personale, vështirësi emocionale ose aspekte të ndryshme të funksionimit shoqëror e profesional (plane karriere, të ardhura etj.).

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin vështirësi në krijimin e marrëdhënieve të afërta me të tjerët, marrëdhënie të karakterizuara nga ndarja e informacioneve personale për qëllimet e jetës, vështirësitë ose problemet emocionale me të cilat përballen.


Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë kanë vështirësi të ndajnë me të tjerët detaje për jetën personale ose për qëllimet dhe aspiratat që kanë. Gjithashtu, rezultatet e larta karakterizohen nga krijimi i marrëdhënieve të distancuara e formale me të tjerët, ku diskutimi i aspekteve personale a intime konsiderohet i papranueshëm.

CT17

Theksimi i problemeve

B: 24 | T: 75 | C: 99%



Përkufizim: Shkalla identifikon prirjen për t'i paraqitur problemet personale, vështirësitë emocionale ose ato shëndetësore si shumë më të rënda nga ç'janë në të vërtetë. Shpesh këto rezultojnë të ekzagjeruara ose edhe të sajura.

Përshkrime të lidhura me rezultate të ulëta:

Personat me rezultate të ulëta në këtë shkallë nuk shfaqin prirjen për t'i perceptuar vështirësitë e veta emocionale si pothuajse të pamundura për t'u menaxhuar, përkatësisht si pengesë edhe në detyra banale a rutinore. Rezultatet e ulëta në këtë shkallë nuk tregojnë domosdoshmërisht mungesën e problemeve a vështirësive në rrafshin emocional.

Përshkrime të lidhura me rezultate të larta:

Personat me rezultate të larta në këtë shkallë priren ta mbivlerësojnë intensitetin e problemeve personale, qoftë atyre në rrafshin shoqëror a profesional, qoftë atyre në rrafshin e gjendjes shëndetësore. Këta persona kanë ndjesinë se problemet e tyre emocionale janë aq intensive sa ndërhyjnë në veprimtaritë e përditshme ose edhe në detyra të thjeshta a banale.